

**Fjala e Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit, z. Visho Ajazi Lika,
në ceremoninë e dekorimit të SHISH:**

4 korrik 2016, ora 9.30

I Nderuar President i Republikës, Zoti Bujar Nishani!

Të Nderuar Zonja e Zotërinj pjesmarrës në këtë ceremoni!

Të Nderuar kolegë dhe punonjës të SHISH!

Kam nderin, kënaqësinë dhe privilegjin që, në cilësinë e Drejtorit të SHISH, të marr pjesë në këtë ceremoni të veçantë dhe kuptimplotë dhe të pranoj dekoratën me rastin e dekorimit të SHISH, nga Presidenti i Republikës.

I Nderuar Zoti President!

Ju faleminderit për dekoratën e Artë të Shqiponjës, Ju faleminderit për vlerësimin, besimin dhe mbështetjen për SHISH, si një nga institucionet më të rëndësishme të Sigurisë Kombëtare.

Kjo dekoratë është vlerësim dhe motivim për të gjithë punonjësit e SHISH në Qendër dhe në Bazë, për punën e palodhur, sakrificat dhe profesionalizmin që kanë demonstruar ata në realizimin e objektivave, misionit dhe të detyrimeve të tyre ligjore.

Me këtë rast, një falenderim i madh shkon për të gjithë punonjësit e SHISH, të cilët, pavarësisht vështirëve dhe sfidave, kanë punuar me përkushtim të madh për realizimin e detyrave në funksion të Sigurisë Kombëtare.

Falenderoj të gjithë stafin drejtues të SHISH, bashkëpunorët e mi të ngushtë të cilët kanë dhënë një kontribut dhe mbështetje të jashtëzakonshme për Drejtorin e SHISH në drejtimin e institucionit si dhe në menaxhimin dhe motivimin e punonjësve sipas njësive që drejtojnë.

Shfrytëzoj gjithashtu rastin që të falenderoj familjarët e punonjësve të SHISH për mbështetjen morale të vazhdueshme që iu kanë dhënë burrave dhe grave të institucionit që unë drejtoj, në mbështetje të punës dhe sakrificave të tyre të përditshme, për realizimin e detyrave të vështira edhe larg familjarëve dhe të afërmeve të tyre.

Zoti President!

Siç edhe e thatë edhe Ju në fjalën Tuaj, puna e shërbimeve të inteligjencës është e një natyrë të veçantë; kërkon individë me cilësi të veçanta, të

përkushtuar e patriotë, kërkon aftësi për të njohur realitetin, për të mësuar të vërtetën dhe për t'u përshtatur me rrethanat; kërkon bashkëpunim e punë në ekip duke respektuar rregullat e sekretit; kërkon besnikëri ndaj institucionit, ndaj kolegut dhe, mbi të gjitha, ndaj vendit.

Jemi përpjekur dhe do të përpiqemi në vazhdimësi t'i përballojmë sfidat dhe të realizojmë detyrat duke respektuar kushtetutën, aktet ligjore e nën-ligjore, rregullat e rregulloret që normojnë punën e agjencisë sonë, duke mbështetur kuadrot më të mirë, duke përzgjedhur të rinj e të reja me dëshirë, vullnet dhe formim të përshtatshëm profesional, të gatshëm për të sakrifikuar dhe për t'i shërbyer misionit sa fisnik aq edhe delikat të Sigurisë Kombëtare.

Z.President!

Kam sot rastin të risjell në vëmendjen Tuaj faktin se SHISH është aktualisht një shërbim inteligjent modern, me infrastrukturë bashkëkohore, me kuadro profesionale e të përkushtuar, me bashkëpunim shumë të mirë ndër-institucional dhe me bashkëpunim profesional e reciprok të vlerësuar ndërkombëtar.

SHISH ka bashkëpunim dypalësh dhe shumëpalësh me shumë shërbime sekrete partnere, është një partner i besuar në komunitetin e shërbimeve sekrete të NATO-s dhe të Evropës Perendimore; është aktor kontribues dhe i vlerësuar për rolin e dorës së parë në luftën kundër terrorizmit, në sigurinë rajonale dhe atë euro-atlantike. SHISH ndan informacion, analiza e vlerësime si dhe organizon operacione të përbashkëta me disa prej partnerëve dhe aleatëve tanë strategjikë.

Sfidat aktuale dhe ato të perspektivës, kërcënimet tradicionale dhe ato trans-nacionale e asimetrike, fenomenet e reja me të cilat përballemi e duhet të përballemi në të ardhmen kërkojnë edhe më shumë punë, përkushtim e sakrifica; kërkojnë më shumë mbështetje financiare e logjistike për institucionin dhe për burimet informative, si një pjesë e pandarë dhe shumë e rëndësishme e Sigurisë Kombëtare.

Shpreh bindjen dhe besimin tim personal e profesional, si dhe flas në emër të të gjithë punonjësve të SHISH, se do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim e përgjegjësi për t'u përballur me sfidat dhe për t'ia dalë mbanë.

Zoti President!

Edhe një herë Ju faleminderit për dekoratën, Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe mbështetjen Tuaj të vazhdueshme!

Ju faleminderit të gjithëve!